



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	2	viti god. year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTICK	7814/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.949/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga : Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.949/2022 të datës 26.10.2022 të pashtuar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës , në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.949/2022 e datës 26.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 339/2022 i datës 20.10.2022 i Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me arsyetimin e ndryshuar dhe plotësuar sipas këtij vendimi .

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke u bazuar ne Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 38 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 19.09.2022 ka shpallur njoftimin për Konkursin me numër

Reference RN00009932 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Zyrtar për Trajnime”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 04.10.2022 deri me datën 11.10.2022, dhe interesim konkurrimi kanë shprehur 6 kandidatë. Sipas vendimit me numër Ref.292/2022 të datës 14.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore ankuesit i është refuzuar aplikacioni për arsye se i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për këtë pozitë.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 14.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore me datën 17.10.2022 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa kjo e fundit me datën 20.10.2022 përmes vendimit me numër të protokollit 4396 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi, më datë 26.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6461/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 20.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 31.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit me datë 08.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 6885/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6461/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 339 i datës 20.10.2022 nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me numër protokollit 292 i datës 14.10.2022 nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emalin e datës 17.10.2022; Ankesën e ankueses të datës 17.10.2022 për Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Diplomën me numër Nr.1069 të datës 28.12.2009; Vërtetim për marrëdhënie pune e datës 17.10.2022; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 10.09.2019; Vërtetim nga Sekretariati i komisionit qendror të zgjedhjeve i Shtator.2019; Referencë e datës 31.05.2010; Vërtetim i datës 10.09.2019; Shkresë e datës 08.02.2010; Referencë e datës 31.05.2010; Akt emërimin e datës 05.02.2020 të ankuesit; Trusti i datës 05.10.2022; Konkursin me numër reference RN00009932 i datës 99.09.2022 për pozitën Zyrtar për trajnim; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6590/2022 të datës 31.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6885/2022 të datës 08.11.2022; Fletkthesën e datës 31.10.2022; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Vendimin e datës 25.10.2022; Aplikacionin e ankuesit i datës 07.10.2022; PAsqyren e Llogarisë të datës 01.08.2022 deri me datën 05.10.2022; Referencën e datës 31.05.2010; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 17.10.2022; Akt emërimin e datës 05.02.2020; Marrëveshjen për Shërbime të veçanta me numër të protokollit 1620 të datës 10.09.2019;

Vërtetimin lidhur me përvojën e punës Shtator 2019; Vërtetimin me numër të protokollit 475 të datës 10.01.2019; Shkresën e datës 08.02.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Shkresën e datës 04.07.2016; Shkresën e datës 19.06.2013; Vërtetimin e datës 03.04.2013; Diplomën me numër Nr.697 të datës 26.07.2016; Aplikacioni i N.P.Rama i datës 04.10.2022; Diplomën me numër Nr.676 të datës 10.07.2014 N.P; Diplomë me Nr.4148 e datës 23.03.2018 N.P; Certifikatë me Nr.496/24.06.2022 N.P; Certifikatë e datës 03-10.07.2022 N.P; Certifikatën e datës 24.05.2022 N.P; Certifikatën e datës 10.08.2021 N.P; Certifikatën e datës 06-07.08.2020 N.P; Certifikatë e datës 18.02.2020 N.P; Certifikatë e datës 23.10.2019 N.P; Certifikatën e datës 10-13.06.2019 N.P; Certifikatë e datës 12.04.2019 N.P; Certifikatën e datës 29.10.2021 N.P; Certifikatë e datës 22-23.08.2021 N.P; Certifikatë e datës 17-20.06 Bansko; Shkresën e datës 06-10.05.2018; Shkresë e datës 03-05.2018 N.P; Shkresë e datës 01-06.10.2017 N.P; Shkresën e datës 28.02.2011 N.P; Shkresë e datës 27-28.09.2018 N.P; Akt emërim i aplikantës N.Pajaziti i datës 25.05.2018; Dokumentin e Identifikimit; Formularin e vlerësimeve në punë për vitin 2021 e N.P; Formularin e vlerësimeve në punë për vitin 2020 e N.P; Vërtetimin e datës 04.10.2022 N.P.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar ankesa e ankuesit është e pa bazuar **SEPSE**:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se si kushte të veçanta për lëvizje brenda kategorisë janë përcaktuar: *të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në: Gjuhë Angleze, Administratë Publike, ose Menaxhim i Burimeve Njerëzore. **Përvoja e punës:** se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka bërë shkelje lidhur me marrjen e vendimit të datës 14.10.2022 me të cilin ankuesit i është refuzuar aplikacioni si dhe vendimit të datës 20.10.2022 me të cilin ankuesit i është refuzuar ankesa, është i pa bazuar sepse në baze të dëshmive të ofruara Njësia e Burimeve Njerëzore e në Ministrinë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi me rastin e aplikimit në konkursin e datës 19.09.2022 në pozitën "Zyrtar për Trajnime" nuk ka bashkangjitur dokumentacionin ashtu siç është kërkuar sipas konkursit me numër Reference RN00009932 konkretisht dëshminë se nuk është ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk i është shuar ende dhe dëshminë respektivisht vlerësimet për rezultatet në punë, për dy vitet e fundit të cilat kanë qenë si kërkesa të veçanta në pikën 3 dhe 4 të konkursit të datës 19.09.2022, andaj Kolegji duke i'u referuar nenit 41 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: "2.Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë

dy viteve te fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit, ka konstatuar se Vendimi me numër Ref.292/2022 i datës 14.10.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit është në pajtim me nenin 45 paragrafin 3 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se; 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin, ndërsa në kuadër të kësaj edhe Vendimi me numër protokoli 339/2022 i datës 20.10.2022 nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në pajtim me nenin 45 paragrafi 5 dhe 6 i të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 6.Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë, i cili përcakton se „Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar“ konstaton se dispozitivi i vendimit të kontestuar me ankesë është i ligjshëm, mirëpo pjesa e arsyetimit në vendimin e kontestuar me ankesë respektivisht pjesa ku organi i punësimit thekson se „ankuesi nuk ka diplomë në drejtimin përkatës të kërkuar në konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Zyrtar për Trajnim” nuk është e ligjshme, sepse në bazë të provave të lëndës ankuesi posedon Diplomën me Nr.1069 të datës 28.12.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Filozofik në Departamentin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike, po ashtu posedon Diplomën me Nr.697 të datës 26.07.2016 të lëshuar nga Fakulteti Filozofik me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master në Shkenca Politike, andaj nisur nga faktet e lartcekura, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi i ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket arsimimit të kërkuar, që kanë qenë të përcaktuara: *Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në: Gjuhë Angleze, Administratë Publike, ose Menaxhim i Burimeve Njerëzor*“, mirëpo nuk i ka plotësuar dy prej pesë kërkesave të veçanta gjegjësisht kërkesën në pikën 3 dhe 4 të konkursit të datës 19.09.2022 të cilat kanë qenë të përcaktuara si ne vijim: *Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën “mirë” për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit*“, respektivisht ankuesi nuk ka bashkangjitur dokumentacionin ashtu siç është kërkuar sipas konkursit me numër Reference RN00009932 konkretisht dëshminë se nuk është ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk i është shuar ende dhe dëshminë respektivisht vlerësimet për rezultatet në punë, për dy vitet e fundit dhe në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave si organ epror ndryshon arsyetimin e Vendimit me numër protokoli 339/2022 të datës 20.10.2022 të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke konstatuar se ankuesi e ka plotësuar kushtin e konkursit sa i përket arsimimit, mirëpo nuk i ka

plotësuar dy kushtet e veçanta të konkursit, andaj Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoll 339/2022 i datës 20.10.2022 i Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me arsyetimin e ndryshuar dhe plotësuar sipas këtij vendimi .

Andaj, nisur si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.949/2022

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

pet

Proçesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.